



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA ADMINISTRATIVE E SHKALLES SE PARE**

**VLORE**

**Nr.2086 Akti**

**Nr .312 Vendimi**

**Dt.Regj. 09.12.2015**

**Date 10.03.2016**

**VENDIM**

**“NË EMËR TË REPUBLIKËS”**

Sot me date 10.03.2016, Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Vlore e përbëre nga gjyqtari KEN DHIMA, asistuar nga sekretare gjyqësore Kamila Petriti, shqyrtoi ne seance gjyqësore me dyer te hapura çështjen civile me Nr. 2086 akti date 09.12.2015 qe i përket:

**PADITES:** Bujar Muhametaj, i biri Muhametit , dt.27.04.1975 , lindur ne Fier , Komuna Qender, i perfaqesuar vete ne gjykim.

**E PADITUR:** Drejtoria Rajonale Tatimore Fier, përfaqësuar me autorizim nga Ervisa Shabani.

**PERSON I TRETE:** Zyra Vendore te Avokatit te Shtetit, ne mungese.

**OBJEKTI:** Konstatimi i pavlefshmërisë Absolute te Aktit Administrative nr.1 1556 dt.03.09.2015, si dhe zgjidhja e pasojave ligjore te rrjedhura nga ky akt; Shuarja e detyrimeve tatimore te përshkruara ne Njoftim Vlershmin Per Detyrimet Tatimore te mësipërm.



**BAZALIGJORE:** Ligji nr.49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve Administrative, Ligji nr.8560 dt.22.12.1999 "Për Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë", ligji nr.9920 dt.19.05.2008 "Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 115, 116, 117 te Kodit te Procedurave Administrative, Kodi Civil.

Ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor te zhvilluar me dyer te hapura gjykata pasi dëgjoi paditësi i cili kërkoi pranimin e padisë sipas objektit dhe pasi dëgjoi te paditurin i cili kërkoi rrëzimin e padisë si te pabazuar ne prova dhe ne ligj, si dhe shqyrtoi provat e administruara ne dosje dhe bisedoi çështjen ne tërësi, si përfundim,

## V E R E N

Se paditësi Bujar Muhametaj i është drejtuar Gjykatës Administrative te Shkalles se Pare Vlorë me një kërkesëpadi me objekt dhe pale te paditur si më sipër.

Gjykata çmon se kjo padi është ne kompetencën funksionale te kësaj gjykate konform nenit 10/1 te Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" ne baze te te cilit përcaktohet se : *"Gjykata administrative e shkallës së parë shqyrton mosmarrëveshjet administrative të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji, me përjashtim të atyre që lidhen me aktin nënligjor normativ"*.

Gjykata çmon se është ne kompetencën lëndore te kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj çështjeje pasi padia është një prej atyre te parashikuara ne nenin 7/a te Ligjit Nr.49/2012 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" ne baze te te cilit rezulton se : *"a) mosmarrëveshjet që lindin nga aktet administrative individuale, aktet nënligjore normative dhe kontratat administrative publike, të nxjerra gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative nga organi publik"*.

Gjithashtu gjykata çmon se është ne kompetencën tokësore te kësaj gjykate shqyrtimi i kësaj çështjeje pasi sipas nenit 11/1 te Ligjit Nr.49/2012 " Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative" ne baze te te cilit rezulton se : *"Paditë kundër veprimit administrativ shqyrtohen në gjykatën administrative të shkallës së parë, që përfshin territorin, në të*



*cilin organi publik ka kryer veprimin administrativ që kundërshtohet".* Pala e paditur ne kete proces eshte Drejtoria Rajonale Tatimore Fier

Ne përfundim te shqyrtimit gjyqësor rezultoi e provuar se paditësi Bujar Muhametaj ne vitin 2002 ka hapur një biznes me NIPT K23609401V. Rezulton se ne vitin 2002, për arsye familjare nuk e ka ushtruar me aktivitetin. Ne Shkurt te vitit 2015 është paraqitur pranë Drejtorinë Rajonale Tatimore Fier për tu pajisur me Vërtetim qe nuk ka biznes. Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Fier është bere me dije se biznesi i tij figuron aktiv , me NIPT K2360940IV, dhe per kete arsye nuk mund ta pajisej me vërtetim, si dhe per tu pajisur me vërtetim qe nuk ka aktivitet duhet te beja kërkesë për mbyllje te NIPT-it te hapur qe ne 2002 dhe pas çregjistrimit mund te pajisesha me vërtetim.

Pala paditese ka bere kerkerse per cregjistrim prane pales se paditur DRT Fier . Me shkresen nr.1717/1 dt. 16.02.2015 pala paditese eshte njoftuar prej Drejtorise Rajonale Tatimore Fier se c'regjistrimi nuk mund te kryhet , sistemi nuk lejonte c'regjistrimin. Per te realizuar c'regjistrimin duhej te behen deklarimet per periudhat 2012 deri ne 2015, si dhe pagesat per keto periudha.

Ndërsa me shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier "Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore" nr. 11556 dt.03.09.2015 , paditësi është bere me dije se ka detyrime te pashlyera ndaj Drejtorisë se Tatimeve ne vlerën 416.880, për periudhat tatimore 2012-2015 për Tvsh dhe për vitin 2003,2004 për Tatim Fitimin .Për Tvsh gjoba për deklarim te vonuar për vitin 2002,2003,2004,2005, dhe tatim fitimi gjobe dhe interesa për vitet 2003,2004.

Pala paditëse ka ushtruar edhe te drejtën e ankimi dhe rezulton se nga ana e Drejtorisë se Apelimit Tatimor nuk është pranuar ankimi.

Duke qene para faktit qe pala paditëse e ka ushtruar rekursin adminiuistrativ, i është drejtuar gjykates duke kërkuar pavlefshmerine absolute te aktit administrativ Njoftim Vlerësimi nr.1 1556 dt.03.09.2015, si nje akt i cili ka dale ne kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga legjislacioni.

Ne ligjin nr.8650 dt. 22.12.1999 "Per Procedurat Tatimore ne RSH ", ne nenet 33, 35 percaktohet :

Neni 33 Vlerësimi tatimor:

1. *Vlerësimi tatimor është llogaritja qe i ben administrata tatimore shumes se detyrimit tatimor si dhe denimeve administrative e interesave per pagese te vonuar qe detyrohet te paguaje nje tatimpagues. Vleresimi tatimor eshte detyrim ndaj shtetit, i pagueshem ne buxhet i cili i njoftohet tatimpaguesit me shkrim ne menyre te drejteperdrejte ose me sherbim postar.*

*Ne rastin kur per nje tatim kerkohet deklarate tatimore, deklarata percakton detyrimin tatimor te tatimpaguesit dhe ajo konsiderohet tejete:*

*Vleresim tatimor per nje tatim dhe njoftim dhe kerkese per te paguar nje tatim ne afatin e percaktuar ne ligj.*



*Per tatimet e mbajtura ne burim, kur nje tatimpagues nuk paraqet nje deklarate tatimore, administrata tatimore nuk ben ne kete rast nje vleresim tatimor per detyrimin e tatimpaguesit mbi bazen e informacioneve te tjera. Administrata tatimore ne kete rast e konsideron te bere vleresimin tatimor te detyrimit te tatimpaguesit.*

Pra ne baze te nenit 33 te ligjit Nr.8650 "Për procedurat Tatimore", Administrata tatimore ka patur per detyrim te bente llogaritjen e detyrimeve tatimore te cilat nuk ishin deklaruar, dhe duhet te me kishte njoftuar paditesin rregullisht per faktin se eshe mosdeklarues. Kjo gje nuk rezulton ti jete njoftuar paditese me asnje shkrese zyrtare gjate kesaj periudhe prej 13-vjetesh.

Detyrimet e pershkruara ne njoftim vleresimin nr.1 1556 dt.03.09.2015 jane per Tvsh dhe per tatim fitimin dhe nuk jane tatim ne burim qe ne baze te nenti 33 pika 5 te mos me behej vleresim tatimor.

Gjykata cmon se administrata tatimore ka vepruar ne kundersizim me ligjin duke mos bere nje vleresim te detyrimeve te paditesit ne vitin 2002, 2003, 2004, 2005, por nxjerr ne vitin 2015 nje njoftim vleresim pas 13 vitesh, bazuar ne Ligjin nr.9920 dt.19.05.2008 "Per procedurat tatimore ne Republiken e shqiperise". Kjo gje eshte ne kundersizim te hapur me ligjin pasi legji nuk ka fuqi prapavepruese.

Ndersa ne neni 35 te ligjit nr.8650 dt.22.12.1999 thuhet shprehirhisht. Neni 35 Parashkrimi i se drejtes per percaktimin e detyrimit tatimor

1. *E drejta e organeve tatimore per te kontrolluar dhe per te korrigjuar vleresimin e nje*

*detyrimi tatimor, parashkruhet 5 vjetpas lindjes se detyrimit (koha qe tatimi duhej te ishte deklaruar ose paguar, cילו qofte qasti me ifundit ne kohe).*

*Afati i parashkrimit nderpritet ne rastet e meposhtme:*

*Gjate apelimit te ketij detyrimi.*

*Gjate kohezgjatjes se garancise per kete pagese tatimore.*

*Gjate periudhes ne te cilen tatimpaguesi per kete detyrim eshte nen nje hetim zyrtar ne vazhdim, deri ne dhenien e nje vendimi perfundimtar. q) Gjate periudhes ne te cilen tatimpaguesi eshte i perfshire ne nje qeshtje penale qe ka lidhje me kete detyrim tatimor.*

2. *Pas cdo nderprerjeje, afati rifillon qe nga qasti i nderprerjes. Ne qdo rast, e drejta per te kontrolluar dhe per te korrigjuar nje vleresim te nje detyrimi tatimor, parashkruhet 15 vjet*

*pas lindjes se detyrimit tatimor.*

Pra detyrimi i administratës tatimore parashkruhet brenda 5 vitesh nga data kur detyrimi duhej paguar, apo nga data e dorzimit te deklarates dhe nderpritet ne rastet e percaktuara me siper.

Gjate shqyrtimit gjyqesor , nuk rezultoi e provuar qe paditesit ti jete komunikuar detyrimi i pa paguar nga ana e pales se paditur DRT Fier.



Pra ne keto kushte gjykata cmon se akti administrativ i nxjerre nga ana e pales se paditur DRT Fier Njoftim vlersimi me Nr.11556 dt.03.09.2015 eshte ne kundershtrim te hapur me dispozitat ligjore te mesiperme.

Gjithashtu ne nenin nr 32/3 te ligjit nr.8650 "Per procedurat tatimore" pershkruhet: Neni 32 " Crrregjistrimi i tatimpaguesit : "Organet tatimore kane te drejte te cregjistrojne nga regjistri aktiv i tatimpaguesve cdo tatimpagues, kur provohet se ai per cfaredo arsye ne vitin e fundit fiskal nuk ka ushtruar veprimtari. Ne kete rast, keta tatimpagues mbahen pasive ne nje regiister te vecante te organeve tatimore.

2.1.4. Organet tatimore kane te drejte te cregjistrojne cdo tatimpagues, kur provohet se ai per cfaredo arsye, ne vitin e fundit fiskal, nukka ushtruar veprimtari. Ne kete rast, keta tatimpagues mbahen pasive ne nje regiister te vecante te organeve tatimore. Mund te kalohen ne te regjistruar si pasive, te gjithe tatimpaguesit qe gjate vitit te meparshem kalendarik, realisht nuk kane layer xhiro. Theksojme se, ketu behet f ale per tatimpaguesit qe realisht nuk kane kryer xhiro dhe per kete nuk kane deklaruar per me shume se 12 muaj rresht.

Gjykata cmon se pala e paditur DRT Fier, ne zbatim te nenit te mesiperm, duhet te kishte bere c'regjistrimin e subjekti qe ne rastin konkret eshte me cilesine e pales paditese ne Janar 2004, pasi sic provohet edhe me shkresen nr.1717/1 dt.16.02.2015 paditesi figuron mosdeklarues per periudhar 2012-20015. Pra dhe kalimi i subjektit padites ne rregjistrin pasiv, eshte bere ne kundershtrim me ligjin e mesiperm.

Ne Njoftim Vleresimin nr.11556 dt.03.09.2015, per tatimin mbi fitimin per periudhat 2003, 2005 llogaritja e gjobes dhe e interesave eshte ne kundershtrim te hapur si me ligjin e vjeter nr.8650 "Per procedurat tatimore" ashtu edhe me ligjin e ri nr.9920 "Per procedurat tatimore". Pasi llogaritja e gjobes dhe e interesave behet kur subjekti ka patur per te paguar detyrim dhe se ka paguar ate ne afat.

Gjykata cmon se per keto periudha duhet do te ishte e ligjshme vetem gjoba ne masen prej 10.000 lekesh per mosdorezim deklarate dhe jo gjobe dhe interes ne vleren 73.410 per secilen periudhe, vlere kjo e llogaritur ne baze te nje detyrimi te pa llogaritur. Gjithashtur rezulton se paditesi pavarësisht se ka kaluar ne statusin pasiv qe ne vitin 2005, ne sitem i jane llogaritur dhe gjoba per mosdorezim te vendimit te asambles se ortakeve per vitin 2014.

Për sa me sipër gjykata vlerëson se kerkesepadia është e bazuar ne prova dhe ne ligj dhe si e tille duhet te pranohet.

### Për Këto Arsye:

Gjykata, ne baze te Ligjit 9986, date 19.05.2008, Ligji 39/2014, date 17.04.2014, Ligji Nr. 66, date 14.07.2015, Udhezimin nr.33 dt.27.10.2008 "Per faljen e detyrimeve doganore dhe tatimore, si dhe te gjobave e kamatevonesave te papaguara te kontributeve te sigurimeve te detyrueshme shoqerore dhe shendetesore" ,Ligjit



Nr.49/2012 , Ligji Nr.8485, date 12.05.1999 " Kodi i Procedurave Administrative te RSH, Ligji Nr.9920, date 19.05.208 "Për Procedurat Tatimore ne RSH",

### **V E N D O S I:**

1. Pranimin e kerkesepadisë si te bazuar ne prova dhe ne ligj.
2. Konstatimin e pavlefshmërisë absolute te Aktit Administrativ nr.11556 dt.03.09.2015 te nxjerre nga pala e paditur DRT Fier si akt i nxjerre ne kundërshtim me ligjin.
3. Shuarjen e detyrimeve tatimore te qe rrjedhin nga akti administrativ Njoftim Vlersimin Per Detyrimet Tatimore me Nr. 11556, date 03.09.2015.
4. Shpenzimet gjyqësore ne ngarkim te palës se paditur.
5. Ndaj ketij vendimi nuk leshohet urdher ekzekutimi.
6. Ky vendim eshte i ekzekutueshem nga Zyra e Permbarimit menjehere.
7. Ky eshte vendim i formes se prere dhe ndaj tij nuk lejohet ankim

U shpall në Vlorë, sot më dt. 10.03.2016.

**SEKRETARE  
KAMILA PETRITI**

**GJYOTAR  
KENDHIMA**

